



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.868/22
Dt.23.11.2022

Drejtori Komunal i Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/2011), Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/31 dhjetor 2011), Udhëzimin Administrativ me Nr. 24/2012 të datës 22.10.2012 për Kategoritë e Studentëve për Asistencë dhe Kushtet për fitimin e Asistencës si dhe Rregullores Nr.1/2022 për Ndarje të Bursave për Studentë shpallë këtë:

K o n k u r s

Për ndarjen e bursave për vitin akademik 2022/2023

1. Komuna e Istogut, varësisht prej mjeteve financiare që ka në dispozicion, ndan bursa për nxënës dhe studentë të Komunës së Istogut të cilët studiojnë në studimet themelore.
 - 2.1. Për nxënës që vijojnë procesin mësimor në klasat e X-ta e që janë të regjistruar në IAAP, Komuna e Istogut ka paraparë të ndaj **5** bursa ku shuma e bursës është 300,00€, (Treqind Euro) për një vit shkollor.
 - 2.2. Për studentët të cilët janë të regjistruar në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës Komuna e Istogut ka paraparë të ndaj **94** bursa ku shuma e bursës është 700,00€, (Shtatëqind Euro) për vit akademik.
 - 2.3. Për studentët të cilët studiojnë në Universitete ndërkombëtare (të cilat janë të renditura nga numri 1-100 sipas listës së Shangait) shuma është 1.000,00 €, (njëmijë Euro) për të cilën kategori Komuna e Istogut ka planifikuar të ndaj **1** bursa për një vit akademik.
2. Bursat ndahen për çdo vit Akademik bazuar me këtë rregullore.

Kushtet për aplikim

1. Për realizimin e të drejtës në bursë, nxënësit e IAAP duhet të paraqesin dokumentet si në vijim:
 - 1.1. të jetë banor i Komunës së Istogut; **(Certifikata e Vendbanimit)**
 - 1.2. të jenë nxënës të rregullt të IAAP-së klasa X; **(Vërtetimin nga Shkolla)**
 - 1.3. të ketë performancë pozitive të **lëshuar me shkrim nga Drejtoria e shkollës;**
 - 1.4. nota mesatare **të dëshmohet me pasqyrën e notave të lëshuar nga shkolla përkatëse.**
 - 1.5. të mos jetë përfitues i ndonjë burse tjetër **(Vërtetimin nga Shkolla)**
 - 1.6. të mos jetë nxënës i drejtimit Infermieri.
2. Për realizimin e të drejtës në bursë për studentët e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, aplikacionit duhet ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
 - 2.1. të jetë banor i Komunës së Istogut; **(Certifikata e Vendbanimit)**
 - 2.2. të jenë student të rregullt; **(Vërtetimin nga fakulteti)**
 - 2.3. të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër, apo të punësuar; **(të dëshmohet me vërtetim nga fakulteti)**
 - 2.3. të mos kenë humbur vitin akademik gjatë studimeve;
 - 2.4. certifikatën e notave si dëshmi e notës mesatare
 - 2.5. certifikatë e gjendjes së bashkësisë familjare **(e lëshuar nga zyra e gjendjes civile).**
3. Për realizimin e të drejtës në bursë, studentët e Universiteteve ndërkombëtare sipas listës së Shangait, nga numri rendori 1-100, duhet ti plotësojnë kushtet si në vijim;
 - 3.1. të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të Komunës së Istogut; **(e cila dëshmohet me certifikatë të shtetësisë dhe asaj të vendbanimit)**
 - 3.2. të sjellin dëshmi nga fakulteti ku është pranuar si student i rregullt.

Dokumentet për poentim të nxënësve

1. Nxënësit që janë të regjistruar në IAAP duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 1.1. suksesi i bazuar në notë mesatare nga shkolla/klasa paraprake, vlerësohen me max. 20- pikë;
 - 1.2. vërtetimi për gjendjen socio-ekonomike të nxënësit, vlerësohen me 15- pikë;
 - 1.3. vendbanimi (distanca shkollë –shtëpi) vlerësohen me 0.5 pikë për kilometër lartësi;
 - 1.4. nxënësit pa të dy prindërit vlerësohen me 15 pikë ndërsa ata me njërin prind vlerësohen me 10 pikë;
 - 1.5. nxënësi i vetëm nga familja e ngushtë vlerësohet me 5 pikë, dy nxënës vlerësohen me 10 pikë, tre e me shumë 15 pikë;
2. Në rast se nxënësit grumbullojnë pikë të njëjta, përparësi u ipet kandidatëve femra.

Dokumentet për poentim të studentëve

1.Fëmijët e dëshmorëve të luftës, Invalidëve të UÇK-së, të zhdukurve të UÇK-së dhe studentët me nevoja të veçanta do t'ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuar me këtë Rregullore prandaj edhe janë të obliguar të sjellin dëshmi nga instrucionet përkatëse , ndërsa të tjerët do t'ju nënshtrohen kriterëve si me poshtë:

- 1.1. studentët e familjeve të cilët nuk kanë asnjë anëtar nga familja e ngushtë të punësuar dhe nuk krijojnë të ardhura nga asnjë veprimtari, kjo kategori vlerësohet me **10 pikë** ndërsa për njërin prind të pa punësuar vlerësohen me **5 pikë**, **kjo kategori dëshmohen me vërtetim të lëshuar nga Zyra për Punësim në Istog.**
- 1.2. studentët të cili nga familja e ngushtë kanë një anëtar me nevoja të veçanta vlerësohen me **5 pikë**; **kjo kategori dëshmohen me vërtetim të lëshuar nga Handakosi**
- 1.3. studentët i vetëm nga familja e ngushtë vlerësohet me **5 pikë** , dy student vlerësohen me **10 pikë**, tre e me shumë **15 pikë**; **kjo kategori dëshmohen me vërtetim të lëshuar nga fakulteti përkatës.**
- 1.4. studentët nga familja në asistencë sociale, vlerësohen me **10 pikë**; **kjo kategori dëshmohen me vërtetim të lëshuar nga Qendra për punë sociale në Istog.**
- 1.5. Studentët nga familja e ngushtë e invalidit të luftës, studentet nga familja e ngushtë e veteranit të luftës, studentët e viktimave civile të luftës, vlerësohen me **10 pikë**; **kjo kategori dëshmohet me certifikatë përkatëse.**
- 1.6. studentët pa të dy prindërit vlerësohen me **15 pikë** ndërsa ata me njërin prind vlerësohen me **10 pikë**; **kjo kategori dëshmohet me certifikatë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.**
- 1.7. studentët që e kanë notën mesatare mbi 9 vlerësohet me 25 pikë;
- 1.8. studentët që e kanë notën mesatare nga 8 deri 8.99 vlerësohet me 20 pikë;
- 1.9. studentët që e kanë notën mesatare nga 7 deri 7.99 vlerësohet me 15 pikë;
- 1.10. studentet që e kanë notën mesatare nga 6 deri ne 6.99 vlerësohet me 10 pikë;
- 1.11. studentët të cilët vijojnë në drejtimet deficitare vlerësohen me 20 pikë;
- 1.12. studentët të cilët kanë regjistruar vitin e parë të studimeve që kanë notën mesatare minimum 4.5 nga shkolla e mesme do të vlerësohen me 15 pike.

Dokumentet për poentim të studenteve që studiojnë në universitete ndërkombëtare

1.Studentët që studiojnë bachellor në universitete ndërkombëtare vlerësohen sipas kriterëve të përcaktuara si në vijim:

- 1.1. studentët të cilët kanë regjistruar vitin e parë të studimeve që kanë notën mesatare minimum 4.5 nga shkolla e mesme do të vlerësohen me 15 pike.
- 1.2. studentët që e kanë notën mesatare mbi 9 vlerësohet me 30 pikë;
- 1.3. studentët që e kanë notën mesatare nga 8 deri 9 vlerësohet me 20 pikë;
- 1.4. studentët që e kanë notën mesatare nga 7 deri 8 vlerësohet me 15 pikë;
- 1.5. studentët që e kanë notën mesatare nga 6 deri ne 7 vlerësohet me 10 pikë;
- 1.6. studentët pa të dy prindërit vlerësohen me 15 pikë ndërsa ata me njërin prind vlerësohen me 10 pikë;
- 1.7. studentët të cilët vijojnë në drejtimet deficitare të përcaktuara me nenin 5 të kësaj rregullore vlerësohen me 20 pikë;

2. Studentët që studiojnë në universitete ndërkombëtare, konkurrencën do ta zhvillojnë ne mes veti jo me studentët që studiojnë ne universitetet publike në vend.

3. Në rast se studentët grumbullojnë pikë të njëjta, përparësi kanë kandidatët femra e në rast se kandidatët janë të gjinisë së njëjtë përparësi kanë kandidatët që studiojnë lëmi deficitare sipas nenit 5 dispozitë kjo e cila vlen edhe për studentët që studiojnë në universitetet publike brenda vendit.

4. Të drejtë burse brenda një familje mund të këtë **vetëm një përfitues** nëse i plotëson kriteret e parapara sipas Rregullores Komunale.

6. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i kësaj burse nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror (Ministria e Arsimit apo Universiteti) ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë apo i punësuar.

VI. Kohëzgjatja e konkursit:

-**Afati i konkurrimit** është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit përkatësisht, ne ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve ;

-**Aplikacioni** mund të tërhiqet në Qendrën për Shërbim me Qytetar, zyra nr.100 kati përdhes i njeiti pas plotësimit dorëzohet po në të njëjtën zyre.

-**Dokumentet** e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen;



Drejtori DKA-së
Naim Behlulaj

Behlulaj